

KRITERET E KUALIFIKIMIT

**Për Furnizuesit pjesëmarrës në procedurën e shpallur nga KESH Sh.a. (Bleresi):
“FURNIZIMI PRANË PETROLIFERA ITALO ALBANESE (PIA) ME LËNDË DJEGËSE PËR
TERMOCENTRALET LUNDRUESE, VLORË”**

1. Procesi

Procedura do të zhvillohet sipas fazave të depozitimit të informacionit, pranimit, vlerësimit si më poshtë:

- Procedura do të ndahet në këto hapa:
 1. Kualifikim / Ofertim
 - 1.1 Kerkesat ekonomike dhe ligjore
 - 1.2 Oferta financiare
 2. Kontrata
- Furnizuesit e interesuar duhet të paraqesin shprehjen e interesit dhe dokumentacionin ekonomik – tekniko-ligjor kërkuar jo më vonë se data 27.08.2024 ora 14.00 (CET).
- Dokumentacioni me kërkesat ekonomike - ligjore do të paraqitet në kopje elektronike të skanuar pranë adresës elektronike; HFO@kesh.al. Dokumentacioni do të menaxhohet pas përfundimit të afatit të dorëzimit. *Limiti maksimal për çdo mesazh është 25 Mb. Nëse mesazhi e kalon këtë limit, rekomandohet ndarja në më shumë se një mesazh.*
- Oferta financiare do të dorëzohet brenda të njëjtit afat, në zarf të sekretuar pranë Zyrave Qendrore të Bleresit me adresë: KESH Sh.a. Rr. Viktor Eftimiu, Nr. 12, Tiranë, Shqipëri.
- Afati për vlerësimin e dokumentacionit ekonomik – ligjor të dorëzuar do të jetë 03.09.2024.
- Afati për ankimimin do të jetë 3 ditë kalendarike dhe fillon menjëherë nga momenti i njoftimit mbi rezultatet e vlerësimit / kualifikimit. Njoftimi i rezultatit dhe depozitimi i ankesave (nëse ka) do të kryhet nëpërmjet të njëjtës adrese ku është depozituar dokumentacioni.
- Vetëm ofertat financiare të ofertuesve që kualifikohen në fazën 1.1 “Kërkesat për palët e interesuara, dokumentacioni i nevojshëm ekonomik ligjor”, do të shqyrtohen në fazën 1.2 “Oferta financiare”.
- Ofertat ekonomike të Furnizuesve të kualifikuar në fazën 1.1, do të hapen në datën 11.09.2024, ora 11.00 pranë Zyrave Qendrore të Bleresit me adresë: KESH Sh.a. Rr. Viktor Eftimiu, Nr. 12, Tiranë, Shqipëri, në prani të përfaqësuesve të Furnizuesve të kualifikuar.
- Furnizuesi i shpallur fitues duhet të paraqesin pranë KESH brenda datës së dakordësuar midis palëve të gjithë dokumentacionin fizik që kërkohet në këtë procedurë, i cili duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar, e pajisur me vulat përkatëse apostile nëse është lëshuar jashtë vendit, i përkthyer në Anglisht ose Shqip.

- Për pyetje & sqarime gjatë procesit kompanitë e interesuara ju lutemi të kontaktoni pranë adresës elektronike; Nexhat.Hajdari@kesh.al
- Shprehja e interesit mund të paraqitet nga çdo Furnizues që plotëson kriteret për pjesëmarrje në procedurë. Për këtë qëllim shprehja e interesit mund të realizohet edhe nga një bashkim i përkohshëm kompanish. Grupi i kompanive duhet të përcaktojë se cila kompani do jetë përfaqësuese në këtë bashkim dhe do të realizojë të gjithë procedurat/komunikimet në emër të bashkimit. Bashkimi i përkohshëm i kompanive duhet të paraqesë pranë Blerësit kontratën e bashkimit të përkohshëm të tyre për këtë procedurë.
- Në rast se Furnizuesi fitues nuk depoziton dokumentacionin fizik sipas kërkesës së mësipërme, Blerësi rezervon të drejtën të anulojë procesin e lidhjes së kontratës pa patur detyrime për asnjë nga palët.
- Procedura do të konsiderohet e vlefshme edhe në rast pjesëmarrjeje të vetëm një Furnizuesi.
- Ofertat financiare të furnizuesve të pakualifikuar, do t'i kthehen dërguesve nëpërmjet postës.

2. Faza 1.1; Kërkesat për furnizuesit e interesuar, dokumentacioni i nevojshëm ekonomik ligjor.

Furnizuesit e interesuar për pjesëmarrje në procedurën e furnizimit me lende djegëse duhet të depozitojnë dokumentacionin që tregon përputhshmërinë me kërkesat e mëposhtme:

- Dokumentacionin që provon regjistrimin e kompanisë në regjistrin tregtar dhe ekstrakt të plotë (historik) sipas formës së shtetit të origjinës, ku kompania është regjistruar.
- Licencën përkatëse të furnizimit me lëndë djegëse të lëshuar nga entitetet përkatëse.
- Dokumentacionin e lëshuar nga entet përgjegjëse të shtetit përkatës që provojnë se:
 - a. Kompania nuk është në procedura falimentimi;
 - b. Kompania nuk është e dënuar me vendim të formës së prerë për vepra kriminale
 - c. Kompania nuk ka shpallur faliment dhe kompania/ asetet e saj nuk janë subjekt i asnjë procedure përbarimore.

Kjo kërkesë mund të plotësohet me anë të një vetëdeklarimi prej kompanive të interesuara.

- Bilancet financiare të kompanisë për tre (3) vitet e fundit të certifikuar dhe të audituara sipas rregullave të shtetit ku kompania është e regjistruar dhe operon.
- Rezultati financiar (fitim / humbje) para taksimit i secilit prej 3 (tre) viteve konsektive nga 5 (pesë) vitet fiskale duhet të jetë pozitiv (>0), dhe të tregohet qartë në pasqyrat financiare të audituara. Për bashkimet e përkohshme të kompanive çdo pjesëmarrës (kompani) duhet të plotësojë këtë kërkesë.
- Kompania duhet të vetë deklarojë çdo person (personat) si anëtarë i një organi administrativ në kompani, drejtor ose supervisor, aksionar apo partner, apo që kanë rol përfaqësues apo kontrollues në kompani (për çdo kompani anëtare të bashkimit të përkohshëm të kompanive) që nuk është i dënuar apo nuk ka qenë më parë i dënuar me një vendim të formës së prerë të një gjykate.

Kjo kërkesë mund të plotësohet me anë të një vetë deklarimi prej kompanive të interesuara.

- Të përmbushë kriteret e mëposhtme në terma të integritetit të përgjithshëm të kompanisë:
 - a. Kompania (çdo kompani në rast bashkimi kompanish) nuk duhet të jetë listuar si entitet që nuk mund të kryeje veprimtari tregtare në Republikën e Shqipërisë apo vendeve të Bashkimit Europian dhe nuk duhet të jetë në listën e zezë të Institucioneve Ndërkombëtare Financiare (IFI)
 - b. Kompania (çdo kompani në rast bashkimi kompanish) nuk duhet të jetë e listuar në listën e personave/ kompanive të Kombeve të Bashkuara të dyshuara për përfshirje në aktivitete terroriste apo në ndonjë listë të zezë kombëtare apo ndërkombëtare.
 - c. Kompania (çdo kompani në rast bashkimi kompanish) dhe çdo aksioner i saj apo i kompanisë mëmë, duke përfshirë edhe përfituesit fundor të kompanisë bijë dhe mëmë, duke përfshirë drejtuesit e kompanive, nuk duhet të jetojnë, kryejnë aktivitete në, realizojnë operacione tregtare me, apo kanë lidhje me asnjë nga shtetet me embargo nga OFAC dhe/ose subjekt i sanksioneve të BE apo KB ose në shtete që janë në listë të zezë nga BE.

Kjo kërkesë mund të plotësohet me anë të një vetëdeklarimi prej kompanive të interesuara.

- Dokumentet e paraqitura në gjuhë tjetër përveç anglishtes dhe shqipes duhet të jenë të përkthyer në anglisht nga një përkthyes i certifikuar.
- Në rastet e bashkimeve të përkohshme të kompanive, çdo anëtar duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. Marrëveshjen e noterizuar nën të cilën krijohet bashkimi i përkohshëm i kompanive. Marrëveshja e bashkëpunimit midis kompanive duhet të përmbajë përfaqësuesin, përqindjen e pjesëmarrjes në bashkim të secilës prej kompanive dhe komponentët që secila kompani merr përsipër të përmbushë në këtë marrëveshje.
 - b. Prokurën e përfaqësimit
- Kompania (ose çdo kompani pjesëmarrëse në një bashkim kompanish) duhet të depozitojë një listë të azhornuar të aksionarëve dhe informacionin mbi përfituesit fundor të kompanisë dhe/ose personat me të drejta ekzekutive dhe/ose personat që ushtrojnë të drejta kontrolluese mbi kompaninë, apo kanë interes ekonomik ndaj kësaj kompanie. Ky informacion duhet të jepet për individët që përmbushin të paktën një prej kërkesave të mëposhtme:
 - Zotëron në mënyrë direkte / indirekte më shumë se 10 % të aksioneve të kompanisë
 - Zotëron në mënyrë direkte / indirekte më shumë se 10 % të të drejtave për të votuar në kompani
 - Zotëron në mënyrë direkte / indirekte të drejtën për të caktuar apo pushuar shumicën e drejtuesëve të kompanisë
 - Ka të drejtën të ushtrojë, ose ushtron influencë të konsiderueshme apo kontroll mbi kompaninë dhe/ose
 - Kur një kompani dorëzane (trust or firm) plotëson një nga kushtet e mësipërme ku, çdo individ që gëzon të drejta të ushtrojë, ose ushtron influencë të konsiderueshme ose kontroll mbi atë trust apo firm.

Informacioni mbi përfituesit fundor duhet të përmbajë:

- Emrin e tanishëm dhe të mëparshëm
- Nacionalitetin dhe numrin personal të identifikimit
- Shtetin e rezidencës
- Datën dhe vendin e lindjes
- Nivelin e pronësisë/ përfitimit në kompani
- Detaje sesi pronësia, kontrolli apo interesi ekonomik ushtrohet.

Nëse detaje të tilla janë të dokumentuara në një regjistër përfituesi fundor në shtetin ku kompania është e regjistruar kjo kërkesë mund të përmbushet duke referuar regjistrin përkatës dhe duke depozituar këtë regjistër.

- Letër për shprehjen e interesit nga palët vendimmarrëse të kompanisë pjesëmarrëse për pjesëmarrjen në këtë proces (të çdo kompanie në rastin e bashkimit të kompanive)

Kërkesat e veçanta si më poshtë :

- Vlera neto (*Net Worth = value of all assets, minus the total of all liabilities.*) e kompanisë (ose kumulative në rastin e bashkimit të kompanive) nuk duhet të jetë më i vogël se 8 Milion Euro
- Kompania (ose bashkimi i kompanive) duhet të provojë se ka furnizime të ngjashme gjatë 3 viteve të fundit për të paktën 50% të sasisë së lëndës djegëse që Blerësi kërkon, nëpërmjet një apo disa burimeve të besuara të prodhimit (rafinimit). Kompania apo bashkimi i kompanive duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kontratat e furnizimit (vetëm pjesa ku cilësohet afati i kontratës dhe sasia e tregtuar), duke censuruar informacionin konfidencial
 - b. Vërtetime të kryerjes me sukses të furnizimit (në një nga format e aprovuara nga porositësi drejt dhënësit të shërbimit)
 - c. Çdo mënyrë tjetër që provon realizimin me sukses të furnizimit.

Ose

Kompania (ose bashkimi i kompanive) duhet të provojë se ka furnizuar 3 vitet e fundit lëndë djegëse, të paktën 50% të sasisë maksimale së kërkuar. Kompania apo bashkimi i kompanive duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kontratat e furnizimit (vetëm pjesa ku cilësohet afati i kontratës dhe sasia e tregtuar), duke censuruar informacionin konfidencial
- b. Vërtetime të kryerjes me sukses të furnizimit (në një nga format e aprovuara nga porositësi drejt dhënësit të shërbimit)
- c. Çdo mënyrë tjetër që provon realizimin me sukses të furnizimit.
- d. Letër angazhimi nga burime të besuara të prodhimit (rafinimit)/furnizues ku të premtohet sasia e kërkuar e lëndës djegëse që Blerësi kërkon.

Rastet e mos depozitimit të dokumentacionit të kërkuar apo depozitimi i informacionit të rremë apo jo korrekt do të konsiderohen si shkak për mos kualifikim në fazën vijuese.

Për këtë fazë kompanitë duhet të depozitojnë pranë Blerësit:

- Të gjithë dokumentacionin e kërkuar më sipër.
- Çdo dokument tjetër që vlerësohet i dobishëm dhe i vlefshëm për procedurën.

3. Faza 1.2; Oferta financiare

- Kompanitë duhet të paraqesin ofertën ekonomike se bashku me dokumentacion ekonomik teknik jo më vonë se data 27.08.2024.
- Oferta financiare duhet të paraqitet e sekretuar.
- Vlefshmëria e ofertave financiare duhet të jetë deri në datën 28.09.2024.
- Për këtë fazë ofertuesit duhet të dërgojnë pranë Blerësit brenda afatit të fundit i dorëzimit të ofertave, garancinë e ofertës.
- **Garancia e ofertës do të jetë 2% e vlerës totale të ofertuar të kontratës** e lëshuar si Garanci Bankare (via SWIFT) ose Sigurim Oferte nga Kompani Sigurimi të regjistruara në Republikën e Shqipërisë. Si kuotim reference për përlogaritjen e vlerës së kontratës dhe rrjedhimisht të garancisë do të merret Platss i datës 07.08.2024.
- Garancia e ofertës duhet të paraqesë qartësisht vlerën, klientin, përfituesin (Blerësi) dhe duhet të jetë e vlefshme gjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës.
- Mos lëshimi ose përmbajtja jo korrekte e garancisë së ofertës do të konsiderohet si arsye mos kualifikimi për ofertuesin.
- Tërheqja e ofertuesit nga oferta financiare gjatë periudhës së vlefshmërisë së ofertës i jep të drejtën Blerësit të ekzekutojë garancinë e ofertës.
- Oferta financiare vlerësohet sipas çmimit më të ulët.
- Ofertat do të hapen në prezencë të ofertuesve të kualifikuar gjatë fazës 1.1 (prezenca mund të sigurohet edhe online).

4. Faza 3; Aspekte kontraktuale, financiare dhe garancitë

Për për lidhjen me sukses të kontratës kërkohen garancitë e mëposhtme:

- Për lidhjen me sukses të kontratës, furnizuesi / furnizuesit fitues duhet të depozitojnë pranë Blerësit garancitë e mëposhtme të performancës:
 - a) Garanci performance e lëshuar në formën e një Garancie Bankare në shumën sa 10 % e vlerës totale të kontratës
- I gjithë dokumentacioni i depozituar gjatë kësaj procedure do jetë aneks i kontratës
- Sasia, koha e lëvrimit, çmimi njësi, termat e pagesës apo çdo element tjetër i paraqitur në këtë ftesë për pjesëmarrje nuk do jenë subjekt negocimi.

Garanci Bankare Garanci Bankare nënkupton një garanci në një formë të pranueshme për Bleresin, e lëshuar nga një Banke e pavarur me të paktën një Rankim Zyrtar të Kreditit ekuivalent ose më të lartë sesa Klasifikimi i Kërkuar i Bankës (per bankat e regjistruara jashtë Republikës së Shqipërisë) për një shumë jo më pak se ajo e kërkuara si më sipër.

Klasifikimi i Kërkuar i Bankës:

- a) Sipas klasifikimit nga Standard and Poor, një klasifikimi të pakën BBB ose me i larte
- b) Sipas klasifikimit të Moody's, një klasifikim të pakën Ba2 ose me i larte
- c) Sipas klasifikimit të Fitch, një klasifikim të pakën BBB ose me i larte

Rastet e mos depozitimit të dokumentacionit të kërkuar, garancive apo depozitimi i informacionit të rremë apo jo korrekt do të konsiderohen si shkak për mos kualifikim dhe mos lidhje të kontratës.

5. Afatet e realizimit të procedurës për importin e lëndës djegëse.

- Faza e parë, kualifikimi, ofertimi, depozitimi i dokumentacionit të kërkuar prej 07.08.2024 deri 27.08.2024
- Vlerësimi i dokumentacionit, ankesa dhe përgjigje 28.08.2024 deri 12.09.2024
- Kontrata, lëshimi i garancive nga 13.09.2024 deri 28.09.2024
- Data e furnizimit do të negociohet dhe përcaktohet në kontratë por jo më vonë se 28.10.2024

I gjithë dokumentacioni, sjellja ose çdo lloj tjetër keqdashje që do të konsiderohet mashtrim, presion, shtrëngim, konflikt interesi apo çdo shkelje tjetër ligji do të ndiqet sipas legjislacionit Shqiptar në zyrën përkatëse të Prokurorisë dhe Gjykatës.

I gjithë dokumentacioni, duke përfshirë këtë ftesë interesi do të jenë pjesë e kontratës me fituesin/ fituesit. Nuk do të pranohen negociata për terma të paraspecifikuar në këtë ftesë.

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare do të jetë përgjegjëse për ruajtjen e gjithë informacionit të klasifikuar sensitiv të depozituar gjatë procesit. Ju lutemi specifikoni në bazë të politikave të kompanisë tuaj cilin informacion kërkonit që të mbetet sensitiv / konfidencial. Gjithë dokumentacioni jo i klasifikuar i tillë do t'i jepet palëve të interesuara në bazë të kërkesës.

Emri i kompanisë dhe oferta do të mbeten konfidenciale deri në përfundimin e fazës së parë. Emri i kompanisë dhe oferta do të bëhen publike në fund të fazës së parë referuar kërkesave të informimit publik për kompani me kapital shtetëror siç është KESH (Referuar legjislacionit përkatës Shqiptar).

KESH mund të anulojë procedurën në çdo moment para shpalljes fitues të kompanisë/ kompanive (edhe gjatë periudhës së vlefshmërisë së ofertës) pa patur detyrime për asnjë nga palët e përfshira në proces.

KESH mund të anulojë procedurën në çdo moment para lidhjes së kontratës pa patur detyrime për asnjë nga palët e përfshira në proces.

Çmimi ofertuar duhet të përfshijë përfshin të gjitha detyrimet tatimore e fiskale, por nuk duhet të përfshijë TVSH. Për arsye të klasifikimit dhe vlerësimit ofertimi dhe vlerësimet do të realizohen pa vlerën e TVSH.

KESH kërkon të gjithë kompanive të përfaqësohen nga një (1) entitet i vetëm i pavarur, i cili duhet të ketë një emër unik, një adresë qendrore unike, përfaqësues unik dhe të plotësojë të gjithë kërkesat e një kompanie të pavarur komerciale, në përputhje me rregulloret e “Mbrojtjes së Konkurrencës”

Kompanitë e listuara në listën e zezë dhe kompanitë e lidhura drejtpërdrejt me to nuk mund të marrin pjesë në këtë procedurë. Ju lutëm gjeni një listë të kompanive në listën e zezë pranë faqjes www.kesh.al

Adresa web të dobishme:

<https://www.kesh.al/>

<https://www.kesh.al/en/about-us/>

<https://www.kesh.al/assetet-gjeneruese/>

<https://www.kesh.al/programi-i-transparences-i-kesh/programi-i-transparences/>

https://www.drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2018/08/Ligj_119_2014_18.09.2014.pdf

<https://www.infrastruktura.gov.al/>

<https://www.infrastruktura.gov.al/energjetike/>